R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2905/1 prot. Tiranë, më 21.10.2026

Lënda: Bashkërendim mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar"

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj me nr. 6541/8 prot., datë 07.10.2026, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar", së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i relacionit shoqërues të projektligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson marrjen në konsideratë të disa prej sugjerimeve të paraqitura nëpërmjet shkresës sonë nr. 2320/1 prot., datë 31.08.2026 si dhe, referuar relacionit shpjegues, angazhimin për reflektimin e tyre edhe gjatë hartimit të akteve nënligjore në zbatim të projektligjit.

Ndërkohë, si i takon komentit të dhënë në lidhje me ***nenin 11 të projektligjit***, pavarësisht se në relacionin shpjegues është shënuar se komenti është pranuar, në fakt rezulton se në pikën 2/2 të nenit 16 të projektligjit ky sugjerim nuk është reflektuar.

Konkretisht, dispozita vijon të përdorë shprehjen "*niveli i aksesimit për subjektet e interesuara për informacion nga Observatori*", pa bërë dallimin ndërmjet niveleve të aksesit teknik dhe institucional në sistem dhe aksesit të publikut në informacion, përfshirë vënien në dispozicion dhe ripërdorimin e të dhënave.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit i qëndron sugjerimit të përcjellë më parë, duke vlerësuar të nevojshëm reflektimin e tij në tekstin e dispozitës, me qëllim garantimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe për të dhënat e hapura, si dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Për sa më sipër, duke theksuar rëndësinë e zbatimit të sugjerimeve gjatë hartimit të akteve nënligjore përkatëse, Zyra e Komisionerit e vlerëson projektligjin konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërkohë në lidhje me konformitetin në raport me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nevojitet të reflektohet komenti ***mbi nenin 11 të projektligjit.***

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi